

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II ad Cor. III, 17-)

Ekonomi e Financë	Fq.	1
Çâshtja kishtare në Ballkan		8
Numrim i parë i popullsis në Shqypni		17
Cubat		23
5. „Les Confins Albanais administrés per la France“		32
Lajme		38
Biblijografi		48

**KONTROLLI
1974 - 1975**

SHKODER
Shtypshkroja Franciskane
1923

Sh/2828

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

Posta e jonë.

Pajtimtarëve, qi nuk e kanë marrë Numrin e Marsit, u lutena të na bëjnë me dije, se kemi me jau nisë me një herë. U bëjmë mandej me dije të gjithëve se, po e ndalen ket Numrin e parë 1923, na kemi me i njehë per pajtimtarë. Kush nuk duhet me vijue në pajtim, të na e kthejë me një herë ket Numrin.

Tiranë. M. F. — Artikulli na u pelqye e prandej bëj gjith si mujtem per me e botue në ket Numrin e parë. Vendi Bourcart-it, qi na ra edhe ne në dorë, është pernjimënd e shpesh sueme e e dëjë per bibljokët më të mirat. U falena nderës me uzdajë se keni me na nderue edhe me shkrime tjera.

Kavajë M. B. — Shkakun s'e dim as na; pvetni këtu per ket. Per në kjoftë se mund u kondënojmë pa prishë koleksionet kemi me u dergue Numrin qi dishroni. Per pajtim u muerem vesht.

Tiranë. N. U lutena të na ndieni per vonesë e cilla, do t'a mërrni vesht prej letret, nuk kje prej fajit t'onë, por erdhen punët ashtu.

Kavajë. I. F. Gj. U falena nderës per fjalë të bukura e per të persritun të pajtimit. A kishi me mujtë me gjetë shokë t'i perkrahen, mostjeter me pajtime, së Perkohëshmes, qi ju çmo ni aq fort? „Hyllin“ kemi me jau dergue këtu thoni; sa per parë tash duket tregtari qi permëndëni në leter.

Vlonë S. Falemi nderës, por... një gur nuk bëjmë, e prandej u lutena me u bë fjalë mirë nder shokë e dashamirë. Na presim shum prej jush. T'ishte i mjaftueshem numri i pajtimtarëve, na s'kishim me pritue me i shtue fletët e „Hyllit“.

HYLLI I DRITËS

Vjeta IV.

KALLNDUER 1923

Numri I.

Ekonomi e Financë.

Jam tuj shkruar per me paraqitë disa sën de e jo per me korrë lavd, aq mâ teper... pse nder ne po ishte pûnë e kollajtë kjo e lavdit... E po i shkruaj kto sën de per me u lutë e dhe sot, edhe ket herë qi të ruhena prej humnerjet me një gajret atdhedashnije e të thona me a culpa me premtim qi mos me ndëjë mâ mas sodi tuj pritë ndjesë e të falun — sidomos pse nuk kishte me pasë ma se si na falet faji. E po flas si në t'eger pse, mjerisht, detyrët e shtypit janë kë në çmue aq fort prej nesh, e qortimet e fletoreve e të perkohëshmeve, mo s t j e t e r d e r i t a s h, u kan dhânë vetem shkas disa proceseve a davave kû mâ pak kû mâ shum të pa farë arsyeje e disa pamarrveshtjeve të pa themel.

* * *

Ç' se u lirue Shqypnija prej të huejsh e u mkâmë Qeverija Komtare, shpensimet t'ona per zyre qeveritare e per nevojë tjera të Qeveris u kapen deri në njëqind milion frank år, e kta don me thânë se populli i jonë i ka pague Qeveris, tuj perdorë një masë të ndermjemë, ka njëqind frank år per krye. E kta kishte me kë në vetem një kurjozitet statistike, qi kishte me mujtë edhe mos me u vû n'oroe, po të kishte metë ari në shpi t'onë, due me thânë, t'i kishte dalë e t'i delte Shqypnîs me u majtë me çka kà vetë. Por mjerisht, mas një ferkut të gati dy vjetëve, po më duhet me u persritë e me thânë se mentaliteti i jonë është si aj studen-

